



Deloitte.
Legal

Zj. Sabina Lalaj
Partner



Z. Tedi Ibrahimi
Bashkëpunëtor ligjor

Arbitrazhi, padyshim, është njohur si një nga metodat alternative më efektive të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të lindura në kontekstin e marrëdhënieve ndërkombëtare të biznesit bashkëkohor, kryesisht për shkak të shumë përparësive të brendshme që zotëron në krahasim me gjykimin gjyqësor të mosmarrëveshjeve. Globalizimi i ekonomisë dhe rritja e aktiviteteve tregtare ndërkufitare kanë krijuar një mjedis optimal ku arbitrazhi mund të lulëzojë si një mjet në duart e shoqërive, bizneseve dhe investitorëve, të cilët gjithnjë e më shumë kërkojnë vendime të shpejta, konfidenciale dhe të zbatueshme, të marra nga gjyqtarë ekspertë, duke shmangur njëkohësisht pengesat e zakonshme të pranishme gjatë procedurave gjyqësore.

Ndërsa avantazhet teorike të arbitrazhit ndërkombëtar janë të pamohueshme, pengesat e paqarta mbi zbatueshmërinë e vendimeve të arbitrazhit mund të rrezikojnë dobishmërinë praktike të këtij instrumenti. Kryesisht, këto pengesa lindin për shkak të përfshirjes së gjykatave vendase në procesin e arbitrazhit. Përgjithësisht, arbitrazhet rregullohen nga ligji kombëtar, prandaj zbatueshmëria e tyre ka një marrëdhënie të ngushtë, si thelbësore, ashtu edhe procedurale, me gjykatat vendase.¹

Si të tilla, vendimet e arbitrazhit duhet të përmbushin disa kushte të përcaktuara

ligjërish për t'u zbatuar me sukses. Këto kushte, përgjithësisht, pasqyrojnë arsyet e refuzimit të ekzekutimit të vendimit të përcaktuar në Nenin V të Konventës për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Arbitrazhit të Huaj 1958 (këtu e tutje referuar si 'Konventa e Nju Jorkut'). Dispozitat e kësaj të fundit janë përshtatur në legjislacionin kombëtar të shumicës së vendeve që janë nënshkruese të Konventës së New York-ut si edhe të modelit UNCITRAL.²

Me rëndësi të veçantë për qëllimin e këtij artikulli është Neni V (2) (b) i Konventës së Nju Jorkut, ku politika publike shfaqet si një bazë ligjore për të sfiduar ekzekutimin e një vendimi ndërkombëtar arbitrazhi. Ndërsa ky nen përpiqet të pajisë gjykatat vendase me fuqinë e nevojshme "checks and balances" mbi procesin e arbitrazhit,³ ai njëkohësisht krijon mospërputhje dhe pasiguri të mundshme në lidhje me finalitetin e një vendimi arbitrazhi. Politika publike është një koncept fluid, që ndryshon sipas kohës dhe vendit. Reputacioni famëkeq i këtij koncepti buron pikërisht nga vështirësia për të përcaktuar saktësisht thelbin e tij, duke pasur parasysh që një përkufizim i unifikuar dhe autoritativ nuk ka gjasa të shpallet. Në këtë mënyrë, interpretimi dhe zbatimi i mundshëm i përjashtimit të politikës publike, varen plotësisht nga ligjet e shtetit në të cilat kërkohet ekzekutimi i vendimit të



arbitrazhit, ashtu si edhe nga gjyqtari/ gjykata e veçantë që ushtron autoritetin e tij/saj interpretues të parashikuar nga këto ligje.⁴

Megjithatë, pavarësisht paqartësisë kanosëse së nocionit, politika publike është interpretuar ngushtë nga juridiksionet e zhvilluara të arbitrazhit. Në përgjithësi, juridiksionet “miqësore” ndaj arbitrazhit i kushtojnë rëndësi më të madhe lehtësimit të biznesit dhe, në këtë mënyrë, ekzekutimit efikas të gjykimeve që rezultojnë nga mekanizmat alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Ky qëndrim pro-ekzekutimit ndaj vendimeve të arbitrazhit zakonisht është konsideruar si një element më vete i politikës publike. Kështu, dy raste thelbësore nga SHBA-të mund të shërbejnë si një ilustrim i mirë për të shfaqur një qëndrim pro-ekzekutimit. Këto çështje janë *Scherk v Alberto-Culver Co*⁵ dhe *Parsons & Whittemore*.⁶ Në dhënien e vendimit të saj në çështjen e parë, Gjykata vendosi që moszbatimi i marrëveshjes së arbitrazhit në fjalë “do të pasqyrojë një koncept të kufizuar, që të gjitha mosmarrëveshjet duhet të zgjidhen sipas ligjeve tona dhe në gjykatat tona”, ndërsa gjykimi i çështjes së dytë mund të konsiderohet si një hap më tej nga arsyetimi në çështjen e parë, ku gjyqtarët vlerësuan se refuzimi i ekzekutimit të një vendimi të huaj arbitrazhi bazuar mbi politikën publike mund të ndodhte vetëm “kur zbatimi i vendimit do të shkelte nocionet më themelore të moralitetit dhe drejtësisë në shtetin e forumit”. Sipas Gjykatës, në të dy rastet, veprimi ndryshe do të minonte seriozisht dobinë e Konventës së Nju Jorkut.

Sidoqoftë, siç është parashikuar në teori, e rrjedhimisht shfaqur në praktikë,

interpretime më të gjera dhe më të buta të përjashtimit të politikës publike nuk janë të rralla. Ndërsa një interpretim më i lirshëm i konceptit paraqet rrezik për dobinë e arbitrazhit ndërkombëtar, duhet të theksohet se jo të gjitha refuzimet e ekzekutimit të bazuara mbi politikën publike janë të gabuara ose të dëmshme në vetvete. Një rast i tillë përshkruhet më së miri nga çështja *Soleimany v Soleimany*,⁷ ku Gjykata Britanike vendosi kundër ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit duke qenë se kontrata ku përmbahej klauzola e arbitrazhit bazohej në evazion fiskal, dhe si e tillë, ishte në kundërshtim me politikën publike të Mbretërisë së Bashkuar, vendi ku zbatimi i vendimit në fjalë ishte kërkuar. Megjithatë, siç u tha më lart, interpretimi dhe ekzekutimi pasues do të varen nga shumë faktorë, potencialisht edhe jashtë fushës së ligjit.

Përkundrejt këtij sfondi teorik, tani i drejtohem një pamjeje të kuadrit legjislativ shqiptar përsa i përket arbitrazhit, si në lidhje me situatat vendase, ashtu edhe me skenarin ndërkombëtar. Përdorimi vendas i arbitrazhit vazhdon të jetë një mënyrë e pazakontë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në Shqipëri. Shumica dërrmuese e mosmarrëveshjeve që lindin në një skenar vendas trajtohen dhe zgjidhen përfundimisht nëpërmjet mekanizmave klasikë gjyqësorë, të cilat nga ana tjetër janë veçanërisht të ngadalta dhe subjekt i reformimeve të shpeshta. Si rrjedhojë, kjo mund të interpretohet si një nga arsyet kryesore që ndikon në kornizën e dobët ligjore e rregullatore për arbitrazhin vendas në Shqipëri, e cila, më pas, shoqërohet nga një ofertë e munguar në lidhje me shërbimet e arbitrazhit nga dhomat dhe/ose institucionet e arbitrazhit në Shqipëri.⁸



Deri vonë, Shqipëria mbështetej te rregullat e Kodit të Procedurës Civile, dhe më konkretisht në Nenet 400 - 438 të këtij të fundit, për të rregulluar ligjërisht procedurën e arbitrazhit vendas. Sidoqoftë, si pjesë e ndryshimeve më të fundit të Kodit, kapitulli mbi arbitrazhin ku përmbaheshin Nenet e sipërpërmendura u shfuqizua. Megjithatë, shfuqizimi bëhet efektiv në momentin kur një ligj i ri për arbitrazhin do të miratohet.⁹ Edhe pse ky ligj i ri nuk është miratuar ende nga Ligjvënësi Shqiptar, një projektligj është paraqitur për shqyrtim. Pavarësisht se arbitrazhi vendas është ende i mundur në praktikë, ekziston një zbrazëti rregullatore, të paktën derisa të miratohet ligji i ri për arbitrazhin. Përmbajtja e instrumenteve të sipërpërmendura rregullatore, d.m.th., e projektligjit të ri dhe të rregullave të mëparshme të Kodit të Procedurës Civile, është gjerësisht e ngjashme përsa i përket rregullave thelbësore dhe procedurale mbi formën, krijimin, vlefshmërinë, ekzekutimin, apelimin dhe ciklin e jetës së një marrëveshjeje arbitrazhi. Megjithatë, një shmangie e rëndësishme nga formulimet e mëparshme, është pranimi i qartë i politikës publike si bazë për refuzimin e zbatimit të vendimeve të arbitrazhit në nenin 59 (g) të projektligjit të ri, i cili thotë se vendimet e arbitrazhit mund të deklarohen të pavlefshme kur ato janë në kundërshtim me "*rendin publik*" në Republikën e Shqipërisë. Më parë, ligji i referohej "*parimeve themelore të ligjit shqiptar*" si bazë e refuzimit për ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit. Ndërsa të dy formulimet janë interpretuar *mutantis mutantis*, siç do të ilustrimet më poshtë, formulimi i ri anon nga një gjuhë më e përafërt me formulimet e përdorura në Konventën e Nju Jorkut për çështjen në fjalë.

Në kontrast me situatën aktuale të arbitrazhit vendas, Shqipëria ofron një sistem të konsoliduar të njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja të arbitrazhit. Nëpërmjet miratimit të Ligjit Nr. 8688, datë 9.11.2000, Parlamenti i Shqipërisë ka ratifikuar Konventën e Nju Jorkut. Para kësaj, rregullimi ligjor i ekzekutimit të vendimeve të huaja të arbitrazhit ishte parashikuar nga dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, të cilat, në thelb, janë shumë të ngjashme me dispozitat e Konventës së Nju Jorkut. Këto dispozita, të përfshira në Nenet 393-399 të Kodit të Procedurës Civile, mbeten të zbatueshme në rastet kur selia e arbitrazhit është në një vend që nuk është anëtar i Konventës së Nju Jorkut.

Kështu, procedura për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit ndërkombëtar fillon me paraqitjen e një kërkesë në Gjykatën Shqiptare të Apelit përkatëse. Kërkesa për ekzekutim duhet të përmbushë disa kushte procedurale, të paraqitura në nenin IV të Konventës së Nju Jorkut ose në nenin 394 të Kodit të Procedurës Civile. Në vijim, Gjykata kompetente e Apelit nuk e vlerëson çështjen me themel, por vetëm sigurohet që kërkesat e sipërpërmendura procedurale të jenë përmbushur.¹⁰ Vetëm pas kësaj faze, Gjykata mund të vendosë për pranueshmërinë e kërkesës, duke refuzuar kështu ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit, nëse një nga dispozitat e Nenit V ose dispozitat thelbësore të Nenit 394 provohet se ekzistojnë.¹¹ Në këtë kontekst, neni V (2) (b) lejon refuzimin e ekzekutimit të vendimit të huaj të arbitrazhit nëse ky i fundit bie ndesh me politikën publike të Shqipërisë. Ky vlerësim nuk bazohet te përshtatshmëria



e normës së veçantë procedurale apo thelbësore të zbatuar nga forumi i arbitrazhit, por tek efekti që vendimi do të ketë mbi politikën publike shqiptare, si edhe tek përputhshmëria e tij me parimet themelore të ligjit shqiptar. Dukshëm, në mënyrë të ngjashme me situatat vendase, u referohemi dy termave në këtë kontekst, d.m.th., politikës publike nga njëra anë dhe parimeve themelore të ligjit shqiptar nga ana tjetër. Ndërsa termat nuk janë domosdoshmërisht të përputhshëm me një vështrim prima facie, kuptimi i tyre praktik është përafër nëpërmjet interpretimit gjyqësor. Kështu, Gjykata e Apelit e Tiranës, ndërsa argumentonte pse vendimi i arbitrazhit ndërkombëtar në shqyrtim ishte vërtet i vlefshëm dhe si rrjedhojë i zbatueshëm në Shqipëri, dha një interpretim të shkurtër të konceptit të politikës publike Id. në 8, fq. 415.

Referohuni nenit 394(dh) Kodi i Procedurës s Civile i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.¹⁴ Sipas Gjykatës, një përcaktim i qartë i politikës publike nuk mund të gjendet në ligjin shqiptar. Si pasojë, kjo dispozitë e Konventës së Nju Jorkut do të interpretohet në përputhje me nenin 394 (dh) të Kodit të Procedurës Civile. Sipas Gjykatës, këto parime mishërojnë vlerat e përbashkëta të shoqërisë, mbi të cilat bazohet dhe garantohet sundimi i ligjit.¹⁵

Çështja e mësipërme është një nga të paktat raste kur gjykatat shqiptare kanë provuar të interpretojnë dhe zbatojnë konceptin e politikës publike në arsyetimin e tyre gjyqësor për ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit. Edhe pse përkufizimi i konceptit në fjalë është ende për t'u dakordësuar dhe jo përfundimtar, gjykatat rrallë herë, në mos asnjëherë, kanë refuzuar

ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi të vlefshëm proceduralisht, bazuar vetëm në konsideratat e politikës publike. Kjo, nga ana tjetër, nënkupton që Shqipëria ka provuar se është një juridiksion miqësor ndaj arbitrazhit, duke treguar një qëndrim pro-ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar, kur konsiderohet nga pikëpamja e shqyrtimit të politikës publike.

Për ta përmbledhur, arbitrazhi mbetet një opsion jopopullor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve lokale në Shqipëri, pjesërisht për shkak të mungesës së kuadrit rregullator dhe ligjor. Sidoqoftë, me arbitrazhin ndërkombëtar ndodh e kundërta - kuadri ligjor është i pranishëm, dhe praktika gjyqësore ka treguar një qëndrim pro-ekzekutimit duke mohuar rrallë, në mos asnjëherë, zbatueshmërinë e vendimeve të arbitrazhit që janë proceduralisht të vlefshme, thjesht për shkak të konsideratave të politikës publike.

Mohim: Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë artikull janë vetëm deklarata personale të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pozicionin e ICC Albania. Përmbajtja e artikullit është vepra origjinale e autorëve. Autorët marrin përgjegjësinë për çdo shkelje të autorësisë.

Versioni origjinal i artikullit është në gjuhën angleze

¹Sameer Sattar, enforcement of arbitral awards and public policy: Same concept, different approach? Fq. 2.

²Ibid, fq. 3

³A. Tweeddale & K. Tweeddale, Arbitration of Commercial Disputes: International and English Law and Practice, (2005), në parag. 7.84

⁴Id. at 1, pg. 4.

⁵Scherk v Alberto-Culver Co 417 US 506 (1974).

⁶Parsons & Whittemore Overseas Co., Inc. v. Société Générale de l'Industrie du papier (RAKTA) 508 F.2d 969, 975 (2d Cir. 1974).



⁷Soleimany v Soleimany, QB 785 (SC 1999).

⁸Alban Abaz Brati, Procedura Civile, Botimi i Pare, (bot. Dudaj), 2008, pg 81.

⁹Referohuni Nenit 30, i lexuar duke ju referuar nenit 49 i ligjit nr. 122/2013 datë 18.04.2013 “ Mbi disa ndryshime dhe amendime të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës s Civile i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar”.

¹⁰Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 6, datë 01.06.2011, parag. 31.2 – 31.4.

¹¹Ibid. parag. 31.5.; referohuni gjithashtu nenit 397 “Kodi i Procedurës s Civile i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar”.

¹²Id. në 8, fq. 415 .

¹³Referohuni nenit 394(dh) Kodi i Procedurës s Civile i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar

¹⁴Referohuni Vendimit nr. 30-2017-1875, më 05/08/2017 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

¹⁵Ibid. fq. 9.

